

AKTI I THEMELIMIT dhe STATUTI
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
ECO PARK VAU DEJËS SH.P.K.

Neni 1: Themelimi

Sot, me 13 / 01 / 2025 (Janar..... dymijë e njëzet e pesë), në mbështetje të legjislacionit shqiptar respektivisht ligjit Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", themeluesit, kane krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "Eco Park Vau Dejës" shpk.

Ortakët e shoqërisë janë:

- 1. Shoqëria Birra Peja SH.A.**, shoqëri e te drejtës kosovare, regjistruar ne ARBK me numër unik identifikues 811277939, me adresë në Pejë, rr. Nexhdet Basha nr. 160, Kosovë, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, z. Ardian Jusufi, shtetas Kosovar, i biri i Skenderit, lindur në Pejë, Kosove dhe banues në Pejë, lindur më 04.03.1985, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i Letërnjoftimit Kosovar nr. ID0109301 dhe nr. personal Kosovar 1500388109.
- 2. Shoqëria Eco Park Group SH.P.K.**, shoqëri e te drejtës kosovare, regjistruar ne ARBK me numër unik identifikues 810844432, me adresë në Madanaj rr. Qafa, p.n, Gjakovë, Kosovë, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, z. Lorik Fejzullahu, atësia Vesel, shtetas Kosovar, lindur në Mitrovicë dhe banues në Prishtinë, me adresë "Marigona Residence", Colorado 10, Preoc - Kosovë 10000, lindur më 17/03/1980, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i pasaportës me nr. A03814218.
- 3. Shoqëria Future Energy Trading and Exchange Dynamics SH.P.K.**, shkurtimisht **Fuente Dynamics shpk**, shoqëri e te drejtës kosovare, regjistruar ne ARBK me numër unik identifikues 810860272, dhe adresë në rr. Tirana, Objekti Prime Group C4/3, kati II, nr.4, 10000 Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor Admir Bytyçi, atësia Sulejman, amësia Shine, shtetas Shqiptar, lindur në Myç-Has, Kukës dhe banues në TIRANË, me adresë rr. Abraham Linkoln 03910003; Nd. 2; H. 5; Ap. 24; Farkë; Selitë; 1044, lindur më 28/03/1981, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i Letërnjoftimit ID nr. 034862921 dhe nr. personal I10328059M.
- 4. Shoqëria Valorem Energy SH.P.K.**, shoqëri e te drejtës shqiptare, regjistruar ne Regjistrin tregtar me NUIS M11727012K dhe me seli në: Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Abdyl Frasheri, nr. 31, Pallati Hekla, kati i 3te, Tirane. përfaqësuar nga përfaqësuesja ligjore Romina Hasanaj, atësia Fetah, amësia Flutura, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë Spahiu; Nd. 354; Njësia

AJ

L.F

A-B

BJ

Administrative Nr. 1, lindur më 15/04/1994, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtese e Letërnjoftimit ID nr. 038912647 dhe nr. personal J45415042Q.

Neni 2: Përkufizimet

"Marrëveshjet" i referohen së bashku Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit dhe Marrëveshjes së Mbështetjes.

"Marrëveshja për Shërbimet e Balancimit" nënkupton marrëveshjen që lidhet me shërbimet e balancimit për Impiantin Fotovoltaik Solar Eco Park Vau Dejës me një kapacitet të instaluar prej AC 41.8 MW, përkatësisht DC 45.5 MW, i cili do të ketë vendndodhje në Vau i Dejës, Republika e Shqipërisë, dhe që do të nënshkruhet sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Mbështetjes.

"Eco Park Vau Dejës JV" i referohet Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive, përkatësisht konsorciumit të shoqërive të përbërë nga: Eco Park Group SH.P.K, Birra Peja SH.A., Future Energy Trading and Exchange Dynamics SH.P.K, dhe Valorem Energy SH.P.K. Këto subjekte së bashku formojnë konsorciumin fitues sipas shkresës së Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës së Republikës së Shqipërisë të datës 23.07.2024, me numër protokolli 6124, dhe këtu e tutje janë ortakët e shoqërisë.

"Asambleja e Përgjithshme" do të kuptohet si "Kuvendi i Aksionarëve" siç referohet në Kontratën për Bashkëpunim Afarist (Bashkim i Shoqërive).

"Kontrata për Bashkëpunim Afarist (Bashkim i Shoqërive)" nënkupton marrëveshjen e lidhur ndërmjet Eco Park Group SH.P.K, Birra Peja SH.A., Future Energy Trading and Exchange Dynamics SH.P.K, dhe Valorem Energy SH.P.K, e cila është noterizuar në mënyrë të rregullt nga noterja Laura L. Pustina më datë 10.06.2024, në Tiranë, Shqipëri.

"Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës" i referohet Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës së Republikës së Shqipërisë, si Autoriteti Kontraktues dhe nënshkrues i Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit.

"Marrëveshja për Zhvillimin e Projektit" nënkupton marrëveshjen që lidhet me projektimin, financimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Impiantit Fotovoltaik Eco Park Vau Dejës me kapacitet të instaluar prej 41.8 MW, me vendndodhje në Vau i Dejës, Republika e Shqipërisë, e nënshkruar më 20.11.2024 ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit të shoqërive Eco Park Vau Dejës.

"Marrëveshja e Mbështetjes" nënkupton marrëveshjen që është pjesë e Kushteve Paraprake të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit, e cila do të garantohet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të

A-1 L.P A-B BJ

zbatohet për Periudhën e Tregtimit I në formën e një Marrëveshje për Blerjen e Energjisë së shlyer fizikisht, dhe për Periudhën e Tregtimit II në formën e një Kontrate për Diferencë të shlyer financiarisht.

Neni 3: Objekti i veprimtarisë

1. Shoqëria themelohet si një Shoqëri me Qëllim të Posaçëm formën korporative të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K.), me qëllim të vetëm projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e impiantit Eco Park Vau Dejës, duke përfshirë planifikimin, financimin, ndërtimin, eksportin dhe shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit dhe Marrëveshjen e Mbështetjes, siç përcaktohet më poshtë.
2. Duke filluar nga data e themelimit të Shoqërisë, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive, sipas përcaktimeve të paragrafit 1 të këtij Neni, përmes këtij Akti të themelimit dhe Statuti, do të transferohen automatikisht dhe në mënyrë efektive te Shoqëria, duke siguruar që Shoqëria të marrë përsipër tërësisht të drejtat dhe detyrimet e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive - Eco Park Vau Dejës.
3. Themelimi i Shoqërisë bëhet në përputhje me Kontratën për Bashkëpunim Afarist (Bashkim i Përkohshëm) dhe pason pas përzgjedhjes së Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive - Eco Park Vau Dejës si ofertuesi fitues nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës.

Neni 4: Pasqyrimet e Kontratës për Bashkëpunim Afarist (Bashkim i Përkohshëm)

1. Ky Akt Themelimi dhe Statut pasqyron dakordimet e palëve siç janë përcaktuar në Kontratën për Bashkëpunim Afarist (Bashkim i Përkohshëm). Palët në Kontratën për Bashkëpunim Afarist (Bashkim i Përkohshëm) janë ortakë në Shoqëri. Të drejtat dhe detyrimet e tyre si ortakë rregullohen nga ky Akt Themelimi dhe Statut, siç përcaktohet më poshtë.
2. Çdo ndryshim ose amendament i këtij Akti të Themelimit dhe Statuti do të respektojë procedurat e brendshme të Shoqërisë dhe të kalojë nëpër këto procedura, siç përcaktohet më poshtë. Ndryshimet e tilla nuk do të ndikojnë në detyrimet materiale të pranuar përballë Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, duke siguruar që Shoqëria të veprojë në përputhje me detyrimet e saj sipas Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit dhe marrëveshjeve të lidhura.

Neni 5: Detyrimet sipas Marrëveshjeve

1. Shoqëria do të zbatojë Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit të nënshkruar ndërmjet Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive dhe Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës. Detyrimet e Shoqërisë sipas

A.J

LP

A.B



kësaj marrëveshje, siç përcaktohen në tërësi aty, përfshijnë projektimin e plotë, inxhinierinë, prokurimin dhe ndërtimin e Impiantit Fotovoltaik Eco Park Vau Dejës me një kapacitet të instaluar prej AC 41.8 MW në Vau i Dejës, Republika e Shqipërisë.

2. Në respektim të të drejtave dhe detyrimeve të Palëve në Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit, Shoqëria do të përmbushë më pas detyrimet e përcaktuara në Marrëveshjen e Mbështetjes.

Neni 6: Veprimtaria ndihmëse

Shoqëria mund të ndërmarrë çfarëdo aktiviteti tjetër që është i rastësishëm ose që ndihmon në arritjen e objektivave dhe qëllimeve të përmendura në Nenin 3, me kusht që këto aktivitete të jenë në përputhje me rolin e Shoqërisë si një Shoqëri me Qëllim të Posaçëm e themeluar ekskluzivisht për zbatimin e të sipërpërmendurave dhe në masën që këto aktivitete janë në përputhje me përcaktimet e Marrëveshjeve.

Neni 7: Përfshirja me referencë

1. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë, siç përcaktohen në Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit, përfshihen në këtë Akt Themelimi dhe Statut me referencë.

2. Në rast të ndonjë konflikti ose mospërputhje ndërmjet dispozitave të këtij Akti të Themelimit dhe Statuti dhe kushteve të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit, të drejtat dhe detyrimet materiale të përcaktuara në Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit do të kenë përparësi dhe do të mbizotërojnë, me përjashtim të përcaktimeve në paragrafin 3 më poshtë.

3. Dispozitat e këtij Akti të Themelimit dhe Statuti të cilat rregullojnë rregullat e brendshme dhe organizimin e Shoqërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në marrëdhëniet midis ortakëve, strukturën e qeverisjes dhe menaxhimit të Shoqërisë, do të mbeten në fuqi të plotë. Këto dispozita do të rregullojnë çështjet e brendshme të Shoqërisë, përveç nëse bien në kundërshtim me detyrimet materiale të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit.

4. Çdo ndryshim ose modifikim i këtij Akti të Themelimit dhe Statuti që prek të drejtat dhe detyrimet sipas Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit do të kërkojë dhe kalojë nëpër procedurën e miratimit paraprak me shkrim të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, dhe duhet të jetë në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit.

5. Për qëllime të interpretimit të këtij Akti të Themelimit dhe Statuti, çdo term ose kusht që lidhet me detyrimet materiale të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit do të interpretohet ashtu që të jetë në përputhje me qëllimin dhe synimin e Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit.

A.J. L.F

A.B

RJ

Neni 8: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike e Shoqërisë Tregtare “Eco Park Vau Dejës” sh.p.k fillon me regjistrimin juridik dhe fiskal të saj dhe do të vazhdojë për një periudhë të pacaktuar.

Ajo mund të shpërbehet siç përcaktohet me dispozitat e këtij statuti.

Neni 9: Selia, hapësira në internet dhe adresa elektronike

1. Shoqëria e ka selinë ligjore të regjistruar në adresën: Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Abdyl Frasheri, P. Hekla, Tirane.
2. Shoqëria mund të zhvillojë veprimtarinë e saj ekonomike në të gjithë territorin e Shqipërisë si edhe jashtë saj duke hapur degë dhe/ose zyra përfaqësimi, filiale, agjenci etj. në qendra të tjera administrative në përputhje me legjislacionin e vendeve në të cilat ato hapen.

KAPITULLI II

Kapitali dhe kuotat

Neni 10: Shumat dhe pagesat e kapitalit themeltar

Kapitali i shoqërisë është 10.000.000 (dhjetë milione) lekë. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 4 (katër) kuota në zotërim të ortakëve si në vijim:

- Shoqëria Birra Peja SH.A., mbajtëse e 1 (një) kuote, të barabartë me 20% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë, të barazvlefshme me 2.000.000 (dy milione) lekë;
- Shoqëria Eco Park Group SH.P.K., mbajtëse e 1 (një) kuote, të barabartë me 20% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë, të barazvlefshme me 2.000.000 (dy milione) lekë;
- Shoqëria Future Energy Trading and Exchange Dynamics SH.P.K., shkurtimisht Fuente Dynamics shpk, mbajtëse e 1 (një) kuote, të barabartë me 40% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë, të barazvlefshme me 4.000.000 (katër milione) lekë;
- Shoqëria Valorem Energy SH.P.K., mbajtëse e 1 (një) kuote, të barabartë me 20% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë, të barazvlefshme me 2.000.000 (dy milione) lekë;

Kuotat janë nënshkruar nga ortakët dhe do të likuidohen plotësisht deri më 31.12.2025.

Neni 11: Zmadhimi i Kapitalit Fillestar

1. Kapitali fillestar i Shoqërisë mund të zmadhohet në çdo kohë, në një ose më shumë rritje, me kusht që të ketë një vendim nga Asambleja e Përgjithshme.

2. Në rast të një rritje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë në rritje në përpjesëtim me përqindjen e tyre ekzistuese në Shoqëri.

3. Nëse ndonjë ortak zgjedh të mos marrë pjesë në zmadhimin e kapitalit, pjesa e tij mund të merret nga ortakët e tjerë, në përpjesëtim me përqindjen që ata zotërojnë në atë moment në Shoqëri.

Neni 12: Zvogëlimi i Kapitalit

1. Kapitali i Shoqërisë mund të zvogëlohet, me kusht që të ketë një vendim nga Asambleja e Përgjithshme dhe zvogëlimi të mos e çojë kapitalin nën pragu minimal të kërkuar nga ligji.

2. Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të rrezikojë aftësinë paguese të Shoqërisë ose aftësinë e saj për të përmbushur detyrimet.

Neni 13: Tërheqja e Ortakut

1. Deri në një datë jo më herët se tre (3) vjet pas Datës së Operimit Tregtar, çdo ortak duhet të ruajë pronësinë në të njëjtën përqindje në kapital siç ka pasur në Datën e Hyrjes në Fuqi të Marrëveshjes së Zhvillimit të Projektit.

2. Për një periudhë prej dymbëdhjetë (12) vitesh nga përvjetori i tretë (3) i Datës së Operimit Tregtar, çdo transferim i pjesëmarrjes do të kërkojë miratimin paraprak me shkrim të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Zhvillimit të Projektit.

3. Nëse një ortak tërhiqet nga Shoqëria përpara afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni, ortakët e mbetur kanë të drejtë të kërkojnë kompensim për çdo dëm të shkaktuar, dhe paragrafi 5 i këtij Neni nuk do të zbatohet për ortakun që tërhiqet. Kjo përfshin mbulimin e kapitalit të ortakut të tërhequr dhe çdo fitim të humbur të pësuar nga Shoqëria dhe ortakët e mbetur. Nëse Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës kërkon dëmshpërblim sipas paragrafit 1 të këtij Neni, kompensimi i ortakut që tërhiqet ndaj ortakeve të mbetur nuk duhet të jetë më i vogël se shuma e kërkuar nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës.

4. Çdo ortak mund të tërhiqet nga Shoqëria në çfarëdo kohe pas afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij Neni, duke njoftuar me shkrim ortakët e tjerë. Me marrjen e këtij njoftimi, të gjitha të drejtat e ortakut që tërhiqet në Shoqëri do të pushojnë. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

5. Me tërheqjen, ortaku që tërhiqet ka të drejtë në:

1. Kthimin e kapitalit të investuar së bashku me interesin prej 5% të akumuluar gjatë periudhës së investimit, nëse tërheqja ndodh brenda 36 muajve të parë pas periudhës trevjeçare pas Datës së Operimit Tregtar.

2. Pas periudhës së përcaktuar në nënparagrafin 1 të këtij paragrafi, ortaku që tërhiqet ka të drejtë për:

2.1. Kompensim për vlerën e tregut të pjesëmarrjes të tyre, siç përcaktohet në datën e përfundimit të pronësisë në Shoqëri. Vlera e tregut do të vlerësohet nga një vlerësues i caktuar me marrëveshje midis ortakëve të mbetur.

2.2. Pagesën e çfarëdo dividende të detyruar.

6. Nëse Palët nuk arrijnë marrëveshje për vlerën e tregut të pjesëmarrjes, mosmarrëveshja do të zgjidhet sipas përcaktimeve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara në këtë Statut.

7. Me tërheqjen e një ortaku, pjesëmarrja e tij do të transferohet tek ortakët e mbetur në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre në shoqëri.

Neni 14

Transferimi i pjesëmarrjes dhe E Drejta e Parablerjes

1. Pjesëmarrja e Shoqërisë është e transferueshme lirshëm ndërmjet ortakëve, duke iu nënshtruar kufizimeve kohore të vendosura në Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit, siç përcaktohet në paragrafin 1 të Nenit 13 të këtij Akti të Themelimit dhe Statuti.

2. Çdo transferim i pjesëmarrjes, përfshirë edhe dhurimin e tyre palëve të treta, i nënshtrohet të drejtës së parablerjes në favor të ortakëve të tjerë. Një ortak që synon transferimin e pjesëmarrjes së tij duhet të informojë ortakët e tjerë gjatë mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, dhe njoftimi duhet të bëhet me shkrim, duke paraqitur një përshkrim të detajuar të kushteve për transferimin e propozuar.

3. Nëse ortakët e tjerë nuk përgjigjen sipas paragrafit 2 të këtij Neni, ortaku ka të drejtë të transferojë, përkatësisht të shesë pjesëmarrjen tek një palë e tretë. Në rast të një oferte të barabartë gjatë raundit të parë, do të zhvillohet një raund i dytë ofertash. Nëse edhe raundi i dytë rezulton me një ofertë të barabartë, ose nëse nuk ka përgjigje brenda raundit të parë, ortaku mund të vazhdojë me transferimin ose shitjen e pjesëmarrjes tek pala e tretë.

4. Nëse nuk merret asnjë përgjigje brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve nga njoftimi i parë, ose në rast se raundi i dytë nuk arrin të sigurojë një çmim më të lartë, ortaku ka të drejtë të transferojë ose të shesë pjesëmarrjen një tek një palë e tretë.

Neni 15

Përfshirja e ortakut

1. Pas tre (3) vitesh nga Data e Operimit Tregtar, sipas kërkesave të Marrëveshjes së Zhvillimit të Projektit, çdo ortak (i quajtur "Ortaku Shkelës") që vërtetohet se ka kryer veprime që janë materialisht të dëmshme për Shoqërinë dhe Projektin mund të përjashtohet nga Shoqëria. Këto veprime përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, sa vijon:

1.1. Sabotimin përmes veprimeve të qëllimshme të kryera nga Ortaku Shkelës me qëllim pengimin, dëmtimin ose shkatërrimin e operacimeve, asetëve ose reputacionit të Shoqërisë apo Projektit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: ndërhyrje në zbatimin e kontratave apo marrëveshjeve; shkatërrimin e qëllimshëm të dëmit në asetet e Shoqërisë; dhe zbulimin e informacionit konfidencial ose pronësor palëve të paautorizuara me qëllim dëmtimin e Shoqërisë.

1.2. Pengimin e qëllimshëm përmes çdo veprimi të qëllimshëm nga Ortaku Shkelës që ndërpret operacimet e rregullta të Shoqërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: refuzimin për të përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Shoqërisë pa arsye të vlefshme; dobësimin e vendimeve të menaxhmentit ose të politikave të Shoqërisë përmes veprimeve të paautorizuara; dhe mosbashkëpunimin me operacimet e ligjshme të Shoqërisë në një mënyrë që dëmton aftësinë e Shoqërisë për të kryer në mënyrë efektive veprimtarinë e saj.

1.3. Dëm i konsiderueshëm përmes ndërmarrjes së çfarëdo veprimi nga Ortaku Shkelës që shkakton ose ka mundësi të i shkaktojë dëme gjendjes financiare, reputacionit ose aftësisë operacionale të Shoqërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: përfshirjen në aktivitete që sjellin humbje të konsiderueshme financiare ose detyrime për Shoqërinë; veprime mashtrimi, përvetësimi fondesh ose forma të tjera të keqpërdorimit financiar; sjellje që çon në humbjen e kontratave kryesore, klientëve ose punonjësve kyç; dhe shkeljen e ligjeve, rregulloreve ose standardeve etike që rezultojnë në sanksione ligjore ose dëmtim të reputacionit të Shoqërisë.

1.4. Pjesëmarrja ose ndjekja e mundësive që bien ndesh me interesat e Shoqërisë pa deklaram dhe miratim paraprak, duke përfshirë: angazhimin në aktivitete biznesi që konkurrojnë drejtpërdrejt me Shoqërinë; përdorimin e burimeve të Shoqërisë për përfitime personale pa autorizim; dhe hyrjen në marrëveshje ose partneritete që dobësojnë objektivat ose interesat strategjike të Shoqërisë.

2. Shkarkimi mund të iniciohet me vendim/votë unanime të ortakëve të mbetur, duke përjashtuar Ortakun Shkelës. Ortakut Shkelës do t'i dërgohet një njoftim me shkrim për shkarkimin, duke përshkruar

sjelljen specifike që pretendohet të jetë e dëmshme dhe arsyet për përjashtimin. Ortaku Shkelës ka të drejtë t'u përgjigjet pretendimeve me shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e njoftimit.

3. Pas shqyrtimit të përgjigjes së Ortakut Shkelës, sipas përcaktimeve të paragrafit 2 të këtij Neni, nëse ka përgjigje, ortakët e mbetur mund të vazhdojnë me shkarkimin përmes një votimi unanim. Shkarkimi do të hyjë në fuqi menjëherë pas këtij votimi.

4. Ortaku Shkelës do të jetë përgjegjës për të kompensuar Shoqërinë për çfarëdo dëmi të shkaktuar si rezultat i sjelljes së tij. Shuma e dëmit do të përcaktohet nga një nga firmat e BIG 4 (Deloitte, PwC, Ernst & Young (EY), ose KPMG) si vlerësues i pavarur. Firma do të zgjidhet nga ortakët e mbetur, me votim me shumicë të thjeshtë. Shoqëria do të ketë të drejtë të zbrisë shumën e këtyre dëmeve nga çdo pagesë që i detyrohet Ortakut Shkelës pas shkarkimit të tij.

5. Pas shkarkimit, Shoqëria ose ortakët e mbetur do të blejnë pjesëmarrjen e Ortaku Shkelës. Çmimi i blerjes do të jetë vlera e drejtë e tregut e pjesëmarrjeve, e përcaktuar nga një nga firmat e BIG 4 (Deloitte, PwC, Ernst & Young (EY), ose KPMG) si vlerësues i pavarur, minus çdo dëm të shkaktuar Shoqërisë, siç përcaktohet në paragrafin 4 të këtij Neni.

Neni 16

Asambleja e Përgjithshme

1. Organi drejtues i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

2. Kompetencat e mëposhtme i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme dhe duhet të ushtrohen në përputhje me Marrëveshjen e Zhvillimit të Projektit dhe kufizimet ligjore që rrjedhin nga kjo Marrëveshje:

1. Ndryshimi dhe plotësimi i Statutit të Shoqërisë.
2. Rritja ose ulja e kapitalit fillestar të Shoqërisë.
3. Emërimi dhe shkarkimi nga detyra i Administratorëve, drejtorëve, auditorëve, firmave kontabël dhe këshilltarëve të jashtëm.
4. Miratimi i planit të biznesit dhe buxhetit vjetor të Shoqërisë.
5. Autorizimi i shpërndarjeve (dividendit).
6. Lëshimi i kuotave / pjesëmarrjeve të reja, transferimi i pjesëmarrjes ose pranimit i ortakëve të rinj.
7. Vendimi për shpërbërjen e Shoqërisë ose fillimin e procedurave të falimentimit.
8. Vendimi për bashkimin / ndarjen e Shoqërisë me një shoqëri tjetër.
9. Emërimi i auditorit të Shoqërisë.

10. Shitja e projektit.
11. Vendojsa në hipotekë e pjesëmarrjes të Shoqërisë apo Shoqërisë në tërësi për të siguruar kredi bankare.
12. Miratimi i investimeve që tejkalojnë shumën prej 500,000.00 (pesëqind mijë) euro.
13. Çdo kompetencë tjetër parashikuar shprehimisht nga legjislacioni shqiptar në fuqi për asamblenë e përgjithshme.

Neni 17

E Drejta e Pjesëmarrjes dhe Votës

1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.
2. Ortakët ushtrojnë të drejtat e tyre në Asamblenë e Përgjithshme në përpjesëtim me përqindjen e pjesëmarrjes që zotërojnë.
3. Një ortak mund të votojë me anë të një përfaqësuesi gjatë mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Përfaqësimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, duke përfshirë çfarëdo mbledhje të mëvonshme me të njëjtën rend dite.
4. Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i një ortaku në Asamblenë e Përgjithshme.

Neni 18

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve pas përfundimit të vitit fiskal, konkretisht pas auditimit të pasqyrave financiare nga auditori.
2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratori ose nga një ose më shumë ortake të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave.
3. Asambleja e Përgjithshme thirret me anë të njoftimit me shkrim ose me postë elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë vendndodhjen, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet të i dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para datës së caktuar të mbledhjes.
4. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet online duke përdorur një platformë elektronike të përshtatshme, me kusht që të gjithë ortakët të kenë mundësinë të marrin pjesë në mënyrë efektive.
5. Njoftimi për mbledhjen online duhet të bëhet në përputhje me paragrafin 3 të këtij Neni dhe duhet të përfshijë udhëzimet për mënyrën e qasjes në platformën elektronike, si dhe çfarëdo detaji tjetër të

nevojshëm për hyrje (Ang: login) ose kërkesë teknike. Ortakët që marrin pjesë në mbledhjen online do të konsiderohen të pranishëm dhe mund të ushtrojnë të drejtat e tyre për të votuar, për të paraqitur propozime dhe për të marrë pjesë në diskutime sikur të ishin fizikisht të pranishëm. Administratori ose një përfaqësues i caktuar do të sigurojë që të merren të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar një mbledhje online të sigurt dhe efikase, duke përfshirë funksionimin e duhur të platformës elektronike dhe disponueshmërinë e mbështetjes teknike. Nëse ndonjë ortak ka vështirësi teknike që pengojnë pjesëmarrjen e tij në mbledhjen online, mund të kërkojë një riorganizim të mbledhjes ose metodë alternative të pjesëmarrjes, me kusht që këto kërkesa të bëhen përpara mbledhjes.

6. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk thirret sipas paragrafit 3 të këtij Neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm të gjithë ortakët dhe ata pajtohen të vazhdojnë me vendimmarrje, pavarësisht parregullsisë.

7. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme do të kryesohen nga Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme, i cili zgjidhet nga ortakët.

8. Asambleja e Përgjithshme do të caktojë një Sekretar të mbledhjes, i cili mund të jetë ose jo ortak. Sekretari është përgjegjës për hartimin dhe regjistrimin e procesverbalit të mbledhjes.

9. Të gjitha vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve do të dokumentohen dhe nënshkruhen në gjuhën Shqipe.

10. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali duhet të përmbajë datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrat e Kryetarit dhe Sekretarit, si dhe rezultatet e votimeve. Procesverbali duhet të shoqërohet me një listë të pjesëmarrësve dhe njoftimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari dhe hartuesi i procesverbalit.

Neni 19

Kuorumi dhe Marrja e Vendimeve

1. Për mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi konstatohet nëse të paktën 3 nga 4 ortakë janë të pranishëm ose të përfaqësuar, qoftë personalisht apo përmes përfaqësuesit.

2. Vendimet që kërkojnë një shumicë prej tre të katërtat (3/4) miratohen nëse të paktën 75% të pjesëmarrësve votojnë në favor, me kusht që të ketë kuorum siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij Neni. Përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Statut, vendimet kërkojnë shumicë prej tre të katërtat (3/4).

3. Miratimi unanim kërkohet për vendime specifike të listuara në këtë paragraf, apo diku tjetër përgjatë këtij Statuti ku kjo është e përcaktuar shprehimisht. Këto vendime do të miratohen vetëm nëse të gjithë nga gjithësejt 4 ortakët janë të pranishëm ose të përfaqësuar, qoftë personalisht apo përmes përfaqësuesit, dhe të gjithë ortakët votojnë në favor. Çështjet që kërkojnë miratim unanim janë:

1. Ndryshimi dhe plotësimi i Statutit të Shoqërisë.
3. Rritja ose ulja e kapitalit fillestar të Shoqërisë.
4. Lëshimi i kuotave / pjesëmarrjeve të reja, transferimi i pjesëmarrjes ose pranimi i ortakëve të rinj.
5. Vendosja për shpërbërjen e Shoqërisë ose fillimin e procedurave të falimentimit.
6. Vendosja për bashkimin e Shoqërisë me një shoqëri tjetër.

4. Nëse nuk ka kuorum, Asambleja e Përgjithshme nuk mund të vazhdojë me procesin e marrjes së vendimeve deri sa të thirret një mbledhje tjetër e mëvonshme në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë Statut.

Neni 20

Administratori dhe Drejtorët e tjerë

1. Asambleja e Përgjithshme mund të emërojë një ose më shumë Administratorë, të cilët mund të jenë ose jo ortakë, për një mandat deri në 5 (pesë) vjet. Afati i emërimit do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme, por nuk mund të tejkalojë kohëzgjatjen prej 5 (pesë) vite. Administratorët mund të riemërohen për mandate shtesë.
2. Administratorët përfaqësojnë Shoqërinë në marrëdhëniet me palët e treta dhe ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në përputhje me Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare të Republikës së Shqipërisë Nr. 9901, datë 14.4.2008, siç është plotësuar dhe ndryshuar më vonë, dhe Ligjin Nr. 131/2015 për Qendrën Kombëtare të Biznesit, këtë Statut dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
3. Administratorët janë të autorizuar të delegojnë veprime specifike "ad negotia", përkatësisht të caktojnë një person të tretë për të vepruar në emër të tyre posaçërisht për qëllime biznesi ose transaksionesh. Autorizimi për të vepruar duhet të përcaktohet qartë për sa i përket fushëveprimit dhe kohëzgjatjes, duke përkufizuar autorizimin e dhënë për transaksione ose vendime të caktuara.
4. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Administratorin në çfarëdo kohe me një shumicë prej dy të tretave (2/3). Kërkesat që lidhen me kompensimin e Administratoreve, bazuar në marrëdhëniet kontraktuale me Shoqërinë, do të rregullohen nga dispozitat ligjore në fuqi.

A.J. - L.F. A.B.



5. Lorik Fejzullahu, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të identifikimit 1011435471 dhe datë të lindjes 17.03.1980, banorë në Prishtinë, rr. Gazmend Zajmi p.n., emërohet si Administrator për një afat prej 5 vitesh.

6. Pavarësisht parashikimeve të Nenit 16 paragrafi 2 pika 3, pozita e Drejtorit Financiar (Ang: Chief Financial Officer) do të caktohet nga Future Energy Trading and Exchange Dynamics SH.P.K., në cilësinë e tij si ortak. Kjo pozitë është e caktuar si e drejtë e Future Energy Trading and Exchange Dynamics SH.P.K. dhe do të plotësohet sipas diskrecionit të këtij ortaku. Drejtori Financiar do të raportojë drejtpërdrejtë tek Administratori. Drejtori Financiar mund të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, por ai/ajo nuk ka të drejtë vote.

Neni 21

Auditori i jashtëm

Nëse kërkohet me ligj, auditimi i pasqyrave financiare dhe librave të kontabilitetit të Shoqërisë do të kryhet nga një Auditor i Jashtëm i caktuar për një periudhë prej 1 (një) viti, me mundësinë e riemërimit për periudha shtesë nga Asambleja e Përgjithshme. I njeiti mund të shkarkohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 22

Viti financiar dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

1. Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.
2. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për miratimin e bilancit vjetor, pasqyrave financiare, inventarit dhe raporteve të Administratorit dhe, nëse është i emëruar, eksperti i autorizuar i kontabilitetit.
3. Të gjitha dokumentet që lidhen me vitin financiar duhet të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve pas përfundimit të vitit financiar.

Neni 23

Fitimet

Fitimet e përftuara nga bilanci vjetor shpërndahen ndërmjet ortakëve në përpjesëtim me përqindjet e tyre përkatëse. Asambleja e Përgjithshme mund, në rrethana të veçanta, të vendosë krijimin e rezervave speciale ose të jashtëzakonshme, ose të shtyjë shpërndarjen e fitimeve, qoftë pjesërisht apo tërësisht.

A.J

L.F

A.B

Neni 24

Shpërbërja Vullnetare dhe Bllokimi në Vendimarrje

1. Shoqëria mund të shpërbëhet bazuar në një vendim unanim të Asamblesë së Përgjithshme për shpërbërje vullnetare, me kusht që një shpërbërje e tillë të lejohet nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, pas zbatimit të përpiktë të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit.
2. Pas afatit prej (3) vitesh nga Data e Operimit Tregtar, dhe nëse ekziston një mosmarrëveshje e patejkalueshme ndërmjet ortakëve që rezulton në pamundësinë e Asamblesë së Përgjithshme për të marrë vendime, secili ortak mund të iniciojë procesin e ofrimit të blerjes së pjesëmarrjes të zotëruar nga ortaku/ortakët e tjerë.
3. Një nga firmat e BIG 4 (Deloitte, PwC, Ernst & Young (EY), ose KPMG), me seli në Shqipëri, emërohet dhe do të veprojë si vlerësues i pavarur për të përcaktuar vlerën maksimale të pjesëmarrjes. Firma do të zgjidhet nga ortakët e mbetur, me votim me shumicë të thjeshtë. Çmimi i blerjes së pjesëmarrjes nuk mund të tejkalojë kufirin maksimal të përcaktuar nga vlerësuesi i pavarur. Palët do të respektojnë kufirin e çmimit gjatë gjithë procesit të përshkruar në këtë Nen.
4. Njoftimi për fillimin e procesit të ofertës për blerjen e pjesëmarrjes duhet të bëhet me shkrim dhe t'u dorëzohet ortakëve të tjerë. Me dërgimin e këtij njoftimi, Ortaku Ofertues do të specifikojë çmimin e blerjes për pjesëmarrjen e zotëruar nga ortakët e tjerë.
5. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga marrja e njoftimit, ortaku / ortakët duhet të:
 1. Pranojnë ofertën e Ortakut Ofertues dhe të vazhdojnë me shitjen e pjesëmarrjes me çmimin e ofruar;
 2. Refuzojnë ofertën e Ortakut Ofertues dhe të paraqesin një kundëroftër me të njëjtin çmim për blerjen e pjesëmarrjes së tij.
6. Nëse një ortak ka paraqitur një kundëroftër sipas paragrafit 5(2) të këtij Neni, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga marrja e kundëroftës, Ortaku Ofertues duhet të:
 1. Pranojë kundëroftëren dhe të vazhdojë me shitjen e pjesëmarrjes me çmimin e ofruar;
 2. Refuzojë kundëroftëren dhe të paraqesë një ofertë të re ndaj ortakut, me një çmim më të lartë, për blerjen e pjesëmarrjes së tij.
7. Procesi i përshkruar në paragrafët 5 dhe 6 të këtij Neni mund të përsëritet. Nëse një ortak nuk përgjigjet brenda afatit të përcaktuar, do të konsiderohet se ortaku ka pranuar ofertën ose kundëroftëren e ortakut tjetër, dhe transferimi i pjesëmarrjes do të vazhdojë në përputhje me këtë.

A.J

L.F

A.B



8. Çmimi i blerjes së pjesëmarrjes do të paguhet përmes transfertes bankare, dhe transferimi i pjesëmarrjes duhet të përfundojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas pranimit të ofertës ose kundëroftës.

9. Palët heqin dorë nga e drejta për të kundërshtuar vlefshmërinë e procesit dhe çmimin e blerjes të përcaktuar sipas këtij Neni.

Neni 25

Likuidimi

1. Në rastin e shpërbërjes vullnetare, sipas paragrafit 1 të Nenit 24, Shoqëria duhet t'i nënshtrohet procesit të likuidimit.

2. Asambleja e Përgjithshme do të caktojë një ose më shumë likuidatorë për të menaxhuar këtë proces. Likuidatorët janë përgjegjës për paraqitjen e një raporti përfundimtar të likuidimit, ku do të detajohen asetet dhe detyrimet e Shoqërisë, operacionet e kryera të likuidimit dhe koha e nevojshme për përfundimin e procesit.

3. Pas përfundimit të likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do të shqyrtojë dhe do të vendosë mbi bilancin përfundimtar, performancën e likuidatorëve dhe mbylljen e procesit të likuidimit. Pas shlyerjes së të gjitha pretendimeve të kreditorëve dhe mbledhjes së të ardhurave të papaguara, likuidatorët do të shpërndajnë çdo fitim të mbetur ndërmjet ortakëve në përpjesëtim me përqindjet e tyre të kapitalit.

Neni 26

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim ose pretendim që lind nga interpretimi ose në lidhje me interpretimin, zbatimin ose ekzekutimin e këtij Statuti duhet të zgjidhet fillimisht në mënyrë miqësore përmes negociatave. Palët e përfshira në mosmarrëveshje pajtohen që të angazhohen në negociata dhe pajtohen të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të arritur një zgjidhje miqësore brenda tridhjetë (30) ditë nga data kur mosmarrëveshja është njoftuar.

2. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet përmes negociatave me mirëbesim brenda periudhës prej tridhjetë (30) ditë, Palët bien dakord që mosmarrëveshja t'i paraqitet për zgjidhje gjykatës kompetente në Tiranë, Shqipëri. Palët japin në shprehimisht pëlqimin e tyre për juridiksionin e gjykatës kompetente në Tiranë, për shqyrtimin e çdo mosmarrëveshje që lind nga ky Statut.


Neni 27

Dispozitat Përfundimtare


1. Ky Akt Themelimi dhe Statut është nënshkruar në pesë (5) kopje, të gjitha në gjuhën Shqipe, dhe një (1) kopje për çdo ortak.
2. Për çdo çështje që nuk trajtohet në këtë Akt Themelimi dhe Statut, palët do t'i referohen dhe do të zbatojnë dispozitat përkatëse të Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare të Republikës së Shqipërisë Nr. 9901, datë 14.4.2008, siç është plotësuar dhe ndryshuar më vonë, ose çfarëdo ligji tjetër të zbatueshëm i cili është në fuqi në atë kohë.

Nënshkruar me _____ 2025


Ardian Isufi
Birra Peja SH.A.


SH.P.K.
Eco Park Group
Lorik Fejzullahu
Eco Park Group SH.P.K.


Admir Bytyçi
Future Energy Trading and Exchange Dynamics
SH.P.K.


Romina Hasanaj
Valorem Energy SH.P.K.
